



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:099721
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05754529

Kom.Dh.Shk.II.nr.460/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, SH.A., me NUI: 811276957, me seli në Prishtinë, rruga “Bill Clinton”, p.nr., kundër debitorit “R & Rukolli” SH.P.K., me NUI: 810618366, me seli në Prishtinë, rruga “18 Qershori” p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arianit Koci, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1337/23, të datës 23.10.2023, me datën 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “R & Rukolli” SH.P.K, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1337/23, të datës 23.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr. 1337/23, të datës 23.10.2023, në dispozitiv e ka refuzuar

si të pa bazuar prapësimin e debitorit; R & Rukolli” SH.P.K., të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbauesit Privat P.nr.163/23 të dt. 07.04.2023 të përmbauesit privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbaimore dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe për shpenzimet e procedurës me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1337/23, të datës 23.10.2023.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 07.04.2023,, ka paraqitur propozim për përmbaimit ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Kartela e Konsumatorit, me nr. 1492103, nga periudha kohore 31.10.2021 deri më 31.03.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “R & Rukolli” SH.P.K., që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 108.00 €, me kamatë prej 8 %, nga dita e lejimit të përmbaimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet përmbaimore, nën kërcënimin e përmbaimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit,

Përmbauesit privat në Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaimit të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbaimit në bazë të dokumentit

të besueshëm– ekstraktit të verifikuar të librave afarist-kartela e konsumatorit me nr. 1492103, e cilat paraqet dokument përmbarese në bazë të nenit 29 par.1.2 të LPP-së.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin i ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbarim me arsyetimin se kreditori ka dështuar të bëjë të besueshëm propozimin për përmbarim pikë së pari në identifikimin e saktë të debitorit, ashtu që urdhri përmbarimor nuk përmban adresën e saktë të selisë së biznesit të debitorit, duke dështuar t’i përmbahet formës së rregullt të propozimit për përmbarim. Ka shtuar se ekstrakti i paraqitur nga kreditori nuk përmban informatat e pagesave me të dhënat në kartelën financiare të debitorit, sipas të cilës vërehet rregullsia në pagesat mujore drejtuar kreditorit. Më tutje ka deklaruar se kërkesa e kreditorit është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), ndërsa sipas ekstraktit të pagesës llogaritet borxhi që nga data 30.09.2020 nga e cila tanimë kanë kaluar gati tri (3) vite. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e themeltë prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbarimor, si dhe të obligohet kreditori që t’i paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 117.00 € sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim;

Shkalla e parë ka vlerësuar se në rastin konkret Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, në bazë të të cilit është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të o të njëjtit nen, përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti

i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë të pa qëndrueshëm dhe të pa bazuara me ligj, sepse nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të tyre siç është para me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit të përmbarimit të përcaktuar me nenin 71 par. 1 deri në 12, as për shtyrjen e zbatimit të përmbarimit sipas nenit 61 të LPP-së. Vlen të ceket se sipas vlerësimit të gjykatës, në rastin konkret Kartela e Konsumatorit - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me nr. 149213 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në origjinal. vlerëson se pretendimet e debitorit në prapësim, sa i përket detyrimit janë të paqëndrueshme, andaj të njëjtin e refuzoj.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës nuk u provuar se mbi çfarë baze debitorit ka kërkuar parashkrim sipas nenit 360 par.1 të LMD-së, pasi që Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me nr. 149213 nga periudha kohore 31.10.2021 deri më 31.03.2023 në bazë të së cilës përmbaruesi privat ka caktuar përmbarimin, përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i plotësohen kushtet ligjore nga neni 21, 29 par. 1.2 dhe neni 27 , për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim propozimi për përmbarim është paraqitur 07.04.2023, ndërsa faturat e lartcekura janë lëshuar nga data 31.10.2021 e deri me datën 31.03.2023, brenda periudhës tri (3) vjeçare bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar, i ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr. 163/23 të dt. 07.04.2023.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.460/24, me datë 30.05.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti